

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Në epiqendër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/ne-epiqender-te-takimeve-ishte-narkoshteti-berisha-pas-kthimit-ne-s-i514070
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 12:37:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 12:27:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	387d8c22ba8329c8a398daead675ddf0d89f85503e68706e3b48ec8373125cb3
TEKSTI	5734f391449447fe479ac95ffb0c8eb6acad3d48a08a717412a4a7056e81c6ca
PAMJA	5cf1db95a0aeba0c81e319303542ca8aa71e5ab4852a75b095c93bab0cdf8143

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	af1d5d4dce72fd7adcc57bd15db6a92abad9967d4a1f6657debf05d38d1bca84
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	0b6439cf09af002acf6ffba878872d12e4fabe601bb852ed9a98adac17b7c4e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr të eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/af1d5d4dce72fd7adcc57bd15db6a92abad9967d4a1f6657debf05d38d1bca84>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

2 MINUTA ME PARE

"Në epiqendër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!

3 ORE ME PARE

Protestë te Zogu i Zi/ Shoqërohen 10 qytetarë nga policia, disa prej tyre dhunohen me grushta

3 ORE ME PARE

Nis viti i ri shkollor në sistemin parauniversitar / Rënie e numri të nxënësve, trafik i rënduar dhe alarm i rremë për bombë

19 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërisht në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

LIVE UPDATES

"Në epiqendër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!

• Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, u rikthye nga Shtetet e Bashkuara me një mesazh të fortë politik ndaj qeverisë së Edi Ramës, duke deklaruar se në takimet e zhvilluara me zyrtarë të lartë amerikanë, në qendër të diskutimeve ishte ajo që ai e cilësoi si 'narkoshteti' shqiptar. • Gjatë konferencës së sotme për gazetarët, lideri i opozitës tha se vizita në SHBA kishte si qëllim prezantimin e qëndrimit të opozitës shqiptare për situatën politike, ekonomike dhe institucionale në vend. • Sipas kryetarit të PD-së, opozita ka paraqitur në SHBA argumente dhe dokumente mbi lidhjet që ai pretendon se ekzistojnë mes strukturave të pushtetit dhe trafikut të drogës. • Berisha e lidhi këtë situatë edhe me ekonominë dhe krizën demografike të Shqipërisë. • Berisha akuzoi gjithashtu qeverinë se ka krijuar një sistem ku, sipas tij, shteti ligjor është zëvendësuar nga interesat e mafies. • Lideri i demokratëve i kushtoi një pjesë të deklaratës së tij, fjalimit të presidentit amerikan Donald Trump në konventën republikane ku mori pjesë delegacioni shqiptar. • Ai tha se Trump vendosi në qendër të fjalimit të tij dy rreziqe: komunizmin dhe trafikun e drogës. • Gjatë fjalës me gazetarët, kryetari i PD-së akuzoi mediat proqeveritare shqiptare se e kanë censuruar këtë pjesë të fjalimit të Trump. • Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve, Berisha tha se opozita ka gjetur mirëkuptim në takimet e zhvilluara në SHBA dhe se shqetësimet e saj nuk ishin të panjohura për palën amerikane. • Sipas tij, edhe deklaratat e Sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio, për rrezikun që paraqesin kartelet e drogës dhe bashkëpunëtorët e tyre për sigurinë amerikane janë tregues i vëmendjes që SHBA i kushton kësaj çështjeje. • Kryetari i Partisë Demokratike e lidhi gjithashtu situatën me zgjedhjet e fundit në Shqipëri, duke akuzuar qeverinë për përdorimin e strukturave kriminale në procesin zgjedhor dhe duke e cilësuar procesin si 'farsë elektorale'. • Berisha në fjalën e tij, paralajmëroi se opozita do të vijojë aksionin politik dhe hetimor ndaj qeverisë, ndërsa e përmbylli konferencën me një tjetër sulm ndaj Edi Ramës dhe kabinetit të tij.

5 artikuj për këtë temë.

1 ORE ME PARE

Berisha: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!



editoriale

Irena Begiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu


Në vëmendje



Sali Berisha

TIRANA- Kreu i PD-së, Sali Berisha deklaroi ditën e sotme se presidenti amerikan, Donald Trump ka denoncuar rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat sipas tij qëndron regjimi i Ramës. Gjatë një konference për mediat, Berisha u shpreh se mediat proqeveritare në Shqipëri e censuruan plotësisht fjalën e tij.

Më tej, lideri i opozitës tha se rreziku komunist dhe rreziku i trafikeve, janë dy shtyllat mbi të cilat qëndron qeveria e kryeministrit Rama.



Sali Berisha: Miq, në tërësi takimet me kongresmenë, me senatorë, me zyrtarë të lartë të administratës së SHBA, janë paraqitur çdo ditë dhe janë raportuar çdo ditë para shqiptarëve. Por asgjë nuk mund të përshkruhet dy gjëra të tjera. Nuk mund të përshkruhet madhështia, fantazia e konferencës elektorale të Donald Trump, i cili në dy ditë, në ditën e parë me dy orë pa ndërprerje, në ditën e dytë me 35 minuta, e elektrizoi një sallë të madhe, një stadium, që ishte i zjarrtë.

Çdo shqiptar, po të kishte ndjekur fjalën e presidentit Trump dhe konventën, do t'i dukej se në raport me rreziqet kryesore që paraqiti presidenti Trump para publikut amerikan dhe mbarë botës, Shqipëria ishte brenda atij kuadri. Dy ishin rreziqet kryesore. Rreziku komunist dhe rreziku i trafikeve. Nëse ka sot regjim që qëndron mbi këto dy shtylla, është regjimi klasik i Tiranës i Edi Ramës.

Ndaj mesa pamë, mediat proqeveritare censuruan tërësisht fjalën e presidentit Trump dhe rreziqet që ai përcaktoi për SHBA, dhe natyrisht në mënyrë identike për Shqipërinë. Droga dhe komunizmi, komunizmi dhe droga. Çfarë t'u them? Ato dy ditë, në atë konventë ishin dy ditë në fantazi. Në Llozhën e Lirisë, ku na kishin nderuar mua dhe zotin Mediu, ne krahas ndjekjes së seancës, zhvilluam edhe një seri takimesh të shumta. Në llozhë, në mjediset rreth llozhës. Të frytshme dhe me interes të plotë për Shqipërinë dhe të ardhmen e saj./Dosja.al

1 ORE ME PARE

"Shqipëria është kthyer në parcelë eksperimentale të Sorosit"/ Berisha: Në SHBA shprehëm shqetësimin tonë për përdorimin e drejtësisë si armë politike nga Edi Rama!



AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 10:49

SKANDAL/ Policia dhuron protestuesit, momenti kur efektiv i 'Shqiponjave' i gjuan me gusht në bark

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 07:31

Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në Pediatri të QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim

BOTA 14 SHTATOR 2026, 07:21

Analiza e The Economist: Pse Rusia po e dobëson qëllimisht monedhën e saj?

më të klikuarat

Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në Pediatri të QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim

Takimet për Reformën Territoriale/ Rama në Berat: Çfarë lidhje ka distanca? Ndryshon vetëm drejtimi vendor

Tension te Zogu i Zi/ Protestuesit zhvillojnë tubim në ditën e parë të shkollës, shoqërohen disa prej tyre (VIDEO)

"Dil jashtë"/ Egla Ceno rrëfen përplasjen me kryeministrin Rama në Berat: Nuk pati provokime nga ana jonë, unë vetëm i kërkoja të na dëgjonte (VIDEO)

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet kryeministër



Sali Berisha

TIRANA- Kreu i PD-së, Sali Berisha deklaroi ditën e sotme se Shqipëria është kthyer në parcelë eksperimentale të Sorosi. Gjatë një konference për mediat, Berisha u shpreh se gjatë vizitës në SHBA shprehu shqetësimin për përdorimin e drejtësisë si armë politike nga Edi Rama.

Ai theksoi se foli gjithashtu edhe për politizimin e saj në dëmin më të madh të Kushtetutës dhe shtetit ligjor. Më tej, lideri i opozitës tha se paraqiti fakte se si fëmijëve në Tiranë në moshën 13-vjeçare u jepen hormone.



Sali Berisha: Pa diskutim, që si forca politike të shtetit ligjor dhe kushtetutshmërisë, ne shprehëm shqetësimin tonë të madh për përdorimin e drejtësisë si armë politike nga Edi Rama. Politizimin e saj në dëmin më të madh të Kushtetutës dhe shtetit ligjor. Të jemi të hapur, Shqipëria, parcelë eksperimentale e Xhorxh Sorosit, ishte çështje tjetër e rëndësishme. Paraqitëm me fakte, u rrëqethën audienca dhe njerëzit kur dëgjuan se fëmijëve në Tiranë në moshën 13-vjeçare u jepen hormone në një akt kriminal të paparë, të paprecedent kudo në planet në zbatim të doktrinës së Xhorxh Sorosit./Dosja.al

1 ORE ME PARE

"Famëzinjtë Rama, Agasi, Lindat ishin në diskutimet tona"/ Berisha: Denoncuam farsën elektorale, sekretari Rubio nuk e uroi Ramën për zgjedhjet!



Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi


REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by tomorrow.

TIRANA- Lideri i opozitës, Sali Berisha deklaroi se gjatë takimeve të tij në SHBA ka denoncuar farsën elektorale, që sipas tij që organizon kryeministri Rama për të qëndruar në pushtet. Gjatë një konference për mediat, Berisha u shpreh se Sekretari i Shtetit, Marko Rubio nuk e uroi Ramën për zgjedhjet.

Më tej ai shtoi se Rama, Agasi, Lindat ishin në diskutimeve të tyre. Berisha tha se u diskutua gjithashtu se si u përdorën 83 mandate si mburojë e një personi që vetëm me gjashtë dosje kishte 36 vite burg.



Sali Berisha: Në takimet tona, tashmë ato që kemi bërë publike, ne diskutuam gjerësisht për farsën elektorale, që organizon Edi Rama për të qëndruar në pushtet. Për angazhimin e plotë dhe total të kartelevë të drogës në procesin zgjedhor. Paraqitëm fakte, argumente, dokumente, por këto përsëri nuk ishin për miqtë tanë, partnerët tanë rrufe në qiell të hapur. Jo! Sekretari i Shtetit, Marko Rubio nuk e uroi për fitoren e zgjedhjeve Padrinon. Dhe kur gazetarët e pyetën pse nuk e uroi sekretari, zëdhënësi u përgjigj se sekretari uron, përgëzon vetëm asta që bëjnë zgjedhje të lira. Ia la damkën Edi Ramës. Dhe ne patëm mundësi dhe u jemi shumë mirënjohës miqve tanë, kryetarë komisionesh shumë të rëndësishme, nënkryetarë komisionesh kryesore, zyrtarë, drejtues të departamenteve shumë të rëndësishëm të administratës Trump për interesin e madh që treguan.

Por, natyrisht edhe gatishmërinë për të ndihmuar shqiptarët si një popull mik, si një vend mik, për të kapërcyer këto problematika shumë të rënda. Nuk mund ta injoroni në takimet tona përqendrimin e të gjitha pushteteve në duart e Edi Ramës, bllokimin e luftës kundër korrupsionit. Donim, s'donim, por famëzinjtë Balluku, Rama, Agasi, Lindat, etj, ishin personazhe në diskutimet tona. Ishin, nuk e mohoj. Dhe duhej të ishin. Se si u përdorën 83 mandate si mburojë e një personi që vetëm me gjashtë dosje kishte 36 vite burg. Dhe që e presin 60 të tjera për gjykim./[Dosja.al](#)


2 ORE ME PARE

Vizita në SHBA/ Berisha: Në epiqendër të takimeve ishte narkoshteti! Rama, vëllai i tij dhe qeveritarët janë të lidhur direkt me kartelet



TIRANA- Kreu i PD-së, Sali Berisha tha se në epiqendër të takimeve gjatë qëndrimit në SHBA ka qenë narkoshteti i Edi Ramës. Gjatë një konference për mediat, lideri i opozitës akuzoi kryeministrin Rama se është i lidhur me me kartelet e drogës.

Sipas tij, gjatë diskutimeve të zhvilluara në SHBA gjithçka ka qenë në interesin e çdo shqiptari që dëshiron të jetojë i lirë dhe me dinjitet. Ai shtoi se në epiqendër të të gjitha bisedimeve kanë qenë së pari narkoshteti dhe pasojat shkatërrimtare të tij mbi ekonominë, qenien, rendin kushtetues, shtetin ligjor në Shqipëri.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.